

Dekarbonizimi i sektorit të ngrohjes në Kosovë



Tabela e Përbajtjes

-
- 08** Opcionet aktuale në dispozicion për ngrohje të hapësirës për Kosovën
- 10** Dekarbonizimi i sektorit të ngrohjes në Kosovë – Praktikat më të mira
- 10** Praktikat më të mira - Shembuj
- 12** Rekomandime
- 14** Përfundim
- 15** Statistikat kryesore - Infografikë
- 16** Referencat



Shkurtesat



CO₂ - Dioksidi i Karbonit

DH - Ngrohja Qendrore

EC - Komisioni Evropian

EE - Efiçienca e Energjisë

ERO - Zyra e Rregullatorit të Energjisë

EU - Bashkimi Evropian

GDP - Bruto Produkti Vendor

GEFF - Programi për Financimin e Ekonomisë së Gjelbër

GWh - Gigavat orë

HP - Pompat e Nxehtësisë

KAS - Agjencia e Statistikave të Kosovës

PV - Fotovoltaik

SAA - Marrëveshja e Stabilizim Asociimit

Përbledhje ekzekutive



Nuk ka dyshim se dekarbonizimi i sektorit të ngrohjes në Kosovë është një detyrë gjigante dhe sfiduese. Kjo sfidë bëhet edhe më e vështirë për shkak të intensitetit të lartë energetik të ekonomisë kosovare dhe eficiencës së ulët të energjisë në përgjithësi, veçanërisht në sektorin e banimit.

Varfëria energetike, mungesa e krijimit të një plani të ri strategjik kombëtar për ngrohen dhe zbatimi i tij, varësia e lartë nga: prodhimi i energjisë elektrike me bazë fosile, përdorimi i gjërë i burimeve të biomasës të blera në mënyrë të paqëndrueshme, përdorimi i pajisjeve të vjetra dhe joefikase të ngrohjes, mungesa e sistemeve të Ngrohjes Qendore (NQ) dhe mungesa e stimujve për përdorimin e teknologjive të qëndrueshme të ngrohjes, e bëjnë këtë sfidë edhe më të vështirë dhe shumëdimensionale. Të gjitha këto krijojnë probleme shëndetësore për popullatën e Kosovës, shtojnë një kosto të lartë ekonomike, duke përfshirë kostot oportune dhe pengojnë zhvillimin e qëndrueshëm të vendit duke minuar efektin shumëfishues që dekarbonizimi i sektorit të ngrohjes do ta sillte në ekonominë e vendit, të tilla si kursimet e energjisë, zëvendësimi i importit, rritja e vendeve të punës dhe prodhimit në sektorin e eficiencës së energjisë dhe produktivitet më të lartë të forcës punëtore dhe zvogëlimi të faturave për shërbimet shëndetësore.

“Nuk ka dyshim se dekarbonizimi i sektorit të ngrohjes në Kosovë është një detyrë gjigante dhe sfiduese.”



Si e tillë, nevojitet një qasje me shumë palë të interesit për të gjetur zgjidhje të përbashkëta për t'i përmirësuar rezultatet mjedisore të një sektori kaq të rëndësishëm. Një sërë masash nxitëse, mjete politikash dhe veprime konkrete janë paraqitur në këtë punim që vendimmarësit mund t'i ndërmarrin për ta përmirësuar situatën në terren. Kështu, miratimi i këtyre masave do ta përmirësojë shëndetin publik, do ta rrisë produktivitetin dhe do ta rrisë mirëqenien e komuniteteve përmes zbutjes së ndotjes së ajrit në nivel lokal dhe do ta zvogëlojë gjurmën e karbonit në nivel global. Masa të tilla përfshijnë stimulimin e eficiencës së energjisë, zgjerimin e NQ-së ku është e mundur, ndërtimin e impianteve të reja të NQ-së bazuar në biomasë dhe edukimin e njerëzve në ndryshimin e sjelljes së tyre ndaj përdorimit të energjisë për ngrohje.

Vende të ndryshme kanë treguar se është e mundur të kemi një sektor të pastër ngrohjeje edhe përvendet që janë plotësisht të varura nga lëndët djegëse fosile. Politikat dhe mekanizmat mbështetës, ndërgjegjësimi, standardet e eko-dizajnit dhe përgatitja e një plani strategjik kombëtar të ngrohjes me veprime dhe objektiva specifike, si hapat e parë, do të krijojnë një bazë të fortë drejt dekarbonizimit të sektorit të ngrohjes.

Ky studim, përvëç një analize të situatës dhe ofrimit të rekondimeve, përshkruan praktikat më të mira nga vendet që po ndjekin rrugën e dekarbonizimit dhe të ardhmen e sektorit të ngrohjes. Ky studim i shkurtër ofron edhe alternativat më të mira që kanë qytetarët e Kosovës sa i përket alternativave për ngrohjen e hapësirave për ndërtesat e tyre.

Analiza e situatës



Sektori i ngrohjes në Kosovë është i rregulluar me Ligjin për Energjinë dhe dokumente të tjera të rëndësishme strategjike dhe politike përfshijnë: Strategjinë e Energjisë së Kosovës, Strategjinë e Ngrohjes për Kosovën (2011 - 2018) dhe Planin Kombëtar të Veprimit për Eficiencën e Energjisë (2019-2021). Me anëtarësimin në Traktatin e Komunitetit të Energjisë, Kosova ka obligim t'i miratojë dhe zbatojë gjithashtu: Direktivat e Eficiencës së Energjisë, Direktivat për Impiantet e Mëdha me Djegie, etj. Si Palë Kontraktuese e Komunitetit të Energjisë dhe si nënshkruese e Marrëveshjes së Stabilizim Asociiimit (MSA), Kosova detyrohet ta transpozojë dhe zbatojë Acquis Communautaire në lidhje me Eficiencën e Energjisë^[1].

Kosova, si anëtare e Traktatit të Komunitetit të Energjisë, ka obligime që kanë të bëjnë me integrimin e energjisë së ripërtëritshme në përzierjen e përgjithshme të energjisë, pasi objektivi i Kosovës prej 25% energji të ripërtërishme në përzierjen totale është arritur në nivelin 25.69% në vitin 2019 [2]. Megjithatë, objktivi i diskutuar prej 32% deri në vitin 2030 do të jetë i vështirë për t'u arritur vetëm me integrimin e druve të zjarrit dhe biomasës për ngrohje, e cila kryesisht sigurohet në mënyrë të paqendrueshme. Prandaj, nevojiten më shumë investime drejtëpërdrejt në eficiencën e energjisë dhe energjinë e ripërtërishme, veçanërisht në prodhimin e energjisë elektrike, më tej në sektorin e ngrohjes dhe transportit, për t'i përmashur obligimet dhe objektivat e përcaktuara.

Dokumentet dhe strategjitë që kanë të bëjnë me planifikimin e sektorit të

ngrohjes në Kosovë janë të dobëta dhe nuk ofrojnë ndonjë të ardhme ambicioze të qëndrueshme. Dokumenti i fundit që paraqet planin e ngrohjes së Kosovës është "Strategjia e Ngrohjes (2011-2018)". Raporti "Strategjia e Energjisë së Kosovës (2017-2026)" jep disa objektiva që lidhen me sektorin e ngrohjes që kryesisht janë: zgjerimi i rrjeteve ekzistuese të ngrohjes, kryerja e studimeve të fizibilitetit për komunat që nuk kanë NQ dhe master planin e gazit. Fatkeqësisht, sot ende nuk ka ndonjë dokument kombëtar që parasheh të ardhmen e sektorit të ngrohjes për Kosovën. Në rishikimin e Strategjisë së Energjisë, sektori i ngrohjes duhet të mbulohet dhe të ofrojë mundësi të prekshme dhe praktike për qytetarët e Kosovës. Këto duhet të janë në përputhje me obligimet e Kosovës drejt arritjes së objektivave të saj të dekarbonizimit dhe të janë realisht të zbatueshme. Përndryshe, ekziston reziku për përpjekje të sërishtme për të pasur dokumente të mira të politikave, ndërkoqë që zbatimi i tyre është i pamundur, pasi planet hartohen si shumë ambicioze, ose nuk kanë përmbytje për periudhën pasuese dhe përrjedhojë të pazbatueshme.


"Prandaj, nevojiten më shumë investime drejtëpërdrejt në eficiencën e energjisë dhe energjinë e ripërtërishme, veçanërisht në prodhimin e energjisë elektrike"

^[1]The current Energy Strategy of the Republic of Kosovo 2017-2026 is being revised, and will cover the period from 2022 - 2031 and the district heating sector is expected to be covered in this strategy as well.

Cila është situata aktuale në sektorin e ngrohjespër qytetarët e Kosovës?




Sektori i ngrohjes në Kosovë karakterizohet me sisteme individuale dhe autonome të ngrohjes, si dhe me zhvillim shumë të ulët të Ngrohjes Qendrore (NQ). Burimet kryesore të energjisë që qytetarët e Kosovës përdorin për të siguruar ngrohje vijnë kryesisht nga djegia e druve të zjarrit dhe përdorimi i linjtit jashtëzakonisht ndotës për sistemet më të vogla të ngrohjes individuale. Energjia elektrike ka zënë më shumë hapësirë në sektorin e ngrohjes dhe po bëhet gjithnjë e më e rëndësishme pasi BPV-ja rritet me një normë mesatare prej 4% në vit. Në anën tjetër, pjesëmarrja e gazit natyror në sektorin e ngrohjes është minimale në Kosovë.



ASK: Pasqyrë e konsumit të të gjitha burimeve të energjisë në sektorin e ekonomive familjare (%)

Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), biomasa ka pjesëmarrjen më të madhe të energjisë për ngrohje në sektorin e banimit në nivel prej 58% në vitin 2020, e ndjekur nga konsumi i energjisë elektrike në sektorin e ngrohjes me 38%. Për sektorin industrial, totali i energjisë kryesore të përdorur dhe burimi më i rëndësishëm rrjedhë nga produktet e naftës 63%, energjia elektrike 27%, qymyri 5% dhe biomasa 5%. Në sektorin e shërbimeve, Kosova ka një situatë të ndryshme ku energjia elektrike është burimi kryesor i energjisë që përdoret në një nivel prej 55%, derivatet e naftës 28%, biomasa 8%, qymyri në 5% dhe nxehtësia e prejardhur me 4%.

Bazuar në të dhënat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës, konsumi i biomasës ka vazhduar të rritet për 60% nga viti 2012 deri në vitin 2020. Më shumë se 40% e ekonomive familjare në vitin 2018 nuk mund t'i ngrohin shtëpitë e tyre në mënyrë adekuate. Afër një e katërtë e familjeve në Kosovë kanë probleme me izolimin bazë në shtëpitë e tyre, si rrjedhje në vende të ndryshme si pasojë e izolimit të dobët.



Prandaj, situata në terren krijon probleme për ekonominë dhe popullatën e Kosovës. Mungesa e masave të izolimit dhe eficiencës së energjisë, mbështetja e tepërt në burimet e paqëndrueshme të energjisë, krijojnë nevojën për diversifikimin e burimeve të ngrohjes dhe përmirësimin e rezultateve shëndetësore dhe produktivitetit të popullatës së Kosovës. Kjo nga pikëpamja teknike.

Nga ana tjeter nuk ekzistojnë politika mbështetëse nga shteti, qoftë në lehtësim financier përmiratimin më të gjerë të masave të EE, dhe parimi ndotësi paguan nuk zbatohet, eksternalitetet i kalohen shoqërisë. Nuk ka stimuj tatimorë në fuqi përmirësimin e sektorit të ngrohjes, siç janë pajisjet EE, materialet izoluese ose shërbimet. Fondi përmirësimin e sektorit të ngrohjes, siç është në disposicion përmirësimin e sektorit publik. Në Fond përfshihen vetëm sektorit publik. Asnjë ndërgjegjësim nuk bëhet në mënyrë sistematike, kjo kryesisht ndërmerret ad hoc nga OSHC-të.

Opcionet aktuale në dispozicion për ngrohje të hapësirës për Kosovën



Providing space heating for the citizens of Kosovo is difficult. More than 40% of citizens cannot afford to provide sufficient heating for their homes [6]. The current space heating available options are highly dependent on firewood and electricity, and the production and use of these sources has been mostly conducted in an unsustainable manner.




Dru zjarri

Ngrohja me dru në Kosovë bëhet në mënyrë të paqëndrueshme, kryesisht për shkak të: prerjes ilegale të druve të zjarrit, keqmenaxhimit dhe mungesës së praktikave të qëndrueshme pyjore dhe pajisjeve të vjetra joefikase për ngrohje [3]. Kjo lë pas probleme mjedisore të mbeteturinave, duke përfshirë shkatërrimin e pyjeve, humbjen e habitatit, shkatërrimin e rrjedhave ujore, erozionin, ndotjen e ajrit, për të përmendur vetëm disa, megjithatë ai mbetet burimi më në dispozicion për shumicën e popullsisë.




Gazi natyror

nuk është natyrshëm i disponueshëm në vend dhe duhet të importohet ose në kontejnerë nën presion ose nëpërmjet ndërtimit të një rrjeti të gjérë dhe të shtrenjtë tubacionesh që e bën të gjithë procesin të diskutueshëm për sa i përket fizibilitetit dhe paqëndrueshmëria e çmimeve e bën këtë opsjon jo shumë të sigurt financiarisht.



Energjia e ripërtëritshme

në sektorin e ngrohjes është shumë e vogël, me ngrohjen diellore të ujit në çati si forma më e përhapur e energjisë nga burimet alternative, ndërsa energjia gjeotermale përdoret në raste jashtëzakonisht të rralla dhe është kryesisht e paeksploruar. Zgjidhjet novatore, si energjia e erës për ngrohje, në thelb nuk ekzistojnë.



Ngrohja Qendrore

Në Kosovë ekzistojnë katër sisteme të ngrohjes qendrore në katër komuna: Gjakovë, Mitrovicë Veriore, Prishtinë dhe Zveçan. Penetrimi i tyre është i ulët (rrjeti i ngrohjes është i përqendruar kryesisht në zonat urbane). NQ përdor qymyrin (94%) dhe produktet e naftës (6%) si lëndë djegëse parësore [4]. Përveç Gjakovës, e cila së fundi ka ndërtuar një central të kogjenerimit të biomasës dhe elektricitetit me një kapacitet total të instaluar prej 1.2 MW sipas të dhënave nga ZRRE. Ky impiant është një impiant model që mund të replikohet në komuna të tjera si dhe përdor mbetjet nga bujqësia për të gjeneruar nxehësi dhe energji elektrike, duke ripërdorur, për shembull, në një formë të qëndrueshme mbetjet nga vreshtat dhe fushat.



Energjia elektrike

Përdorimi i energjisë elektrike për të siguruar ngrohje - jo vetëm që është i paqëndrueshëm (pasi burimi kryesor i energjisë elektrike vjen nga Kosova A dhe B (centralet e linjës)) - është gjithashtu një barrë për rrjetin elektrik, pasi kërkesa për energji elektrike është më e madhe. Për rrjedhojë, kjo çon në mbingarkesë të rrjetit elektrik, gjë që çon në ndërprerje të shpeshta. Për më tepër, ngrohja me energji elektrike rrit kërkesën dhe si rrjedhojë rrit importin e energjisë elektrike nga vendet fqinje. Pajisjet konvencionale të ngrohjes kanë një efikasitet shumë të ulët dhe mbingarkojnë rrjetin, si dhe janë financiarisht shumë të kushtueshme për t'u përdorur në krahasim me Pompat e Nxehësisë (PN) dhe teknologjitet e reja.

Pompat e nxehësisë

Teknologjitet e reja po përmirësojnë efikasitetin si në kërkësë ashtu edhe në prodhim dhe PN-të po bëhen gjithnjë e më të rëndësishme. Këto pajisje, në varësi të temperaturës së jashtme, mund të kenë raport befasues energjje deri në 10-15 herë më shumë se energjia që konsumojnë vetanake elektrike në krahasim me prodhimin e energjisë termike që realizojnë, krahasuar me gazin natyror që ka një raport prej vetëm 50-90%. PN-të mund të janë jashtëzakonisht të rëndësishme në trajtimin e ndryshimeve klimatike veçanërisht kur ato kombinohen me energjinë elektrike të prodhuar nga energjia e ripërtëritshme [5]. Kjo energji termike e përfthuar nga PN-të që punojnë me energji elektrike është jashtëzakonisht e rëndësishme në trajtimin e ndotjes së ajrit dhe rritjen e efikasitetit të energjisë, si dhe uljen e kërkësës për dru zjarri dhe përdorimin e formave të tjera ndotëse si qomyri, veçanërisht në zonat urbane, duke reduktuar kështu edhe kostot operacionale. Megjithatë, çmimi fillestari i kapitalit për blerjen e këtyre pajisjeve duhet të ulet në mënyrë që të rritet sasia e pajisjeve që aplikohen në masë. Kjo ulje e çmimit mund të arrihet përmes masave fiskale/tatimore.

Dekarbonizimi i sektorit të ngrohjes në Kosovë – Praktikat më të mira



Shumica e ngrohjes së konsumuar përdor forma të bazuara në karbon, prandaj qëndrueshmëria e tyre në afat të gjatë është shumë e diskutueshme. Ekziston nevoja urgjente për dekarbonizimin e sektorit të ngrohjes në Kosovë, si një nga sektorët më ndotës sa i përket ndotjes së ajrit, veçanërisht gjatë dimrit, siç e shohim edhe vetë. Kalimi në energjinë e ripërtëritshme në këtë sektor është jashtëzakonisht i rëndësishëm. Kosova ka një potencial të madh të energjisë së ripërtëritshme - biomasa dhe produktet e biombeturinave janë të pashtfrytëzuara, dhe biomasa/biogazi pothuajse nuk prodhohet. Ky aktivitet ka potencialin të jetë lojtar i rëndësishëm energjetik, prandaj duhet të mbështetet nga qeveria pasi ka një efekt shumëfishues të madh edhe në ekonominë lokale.

Praktikat më të mira - Shembuj



Në vijim pëershkuhen praktikat dhe rastet më të mira nga vendet që po bëjnë progres të madh drejt dekarbonizimit të sektorit të ngrohjes. Këto praktika dhe raste mund të shërbejnë si udhërrëfyes për të trajtuar sfidat me të cilat ballafaqohet Kosova aktualisht dhe për të ofruar zgjidhje të qëndrueshme të ngrohjes për qytetarët e saj.

Mekanizmat kryesorë që përdoren për ofrimin e zgjidhjeve të qëndrueshme të ngrohjes mund të ndahen në këto instrumente: *mekanizmat financiarë - programe stimujsh, politika tatimore, rritja e ndërgjegjësimit, standartet për pajisjet me djegie, ndalimet dhe kufizimet e përdorimit të karburantit të ngurtë dhe standartet e kërkuesave minimale* [7] [8]. Vlen të theksohet se vendet që po aplikojnë këto mekanizma kanë mbështetur vetëm teknologjitë energjetike që janë të qëndrueshme dhe ofrojnë efikasitet të lartë energjetik. Teknologjitë e mbështetura të energjisë së qëndrueshme janë: PN-të, kaldaja dhe pajisjet me eficiencë të lartë, sistemet diellore termike dhe rinnovimi i ndërtimesave, ndër të tjera. Më poshtë janë pëershkuar praktikat e ndjekura nga zbatimi i tyre.

³ ERO - Renewable Energy Capacities Permits - Final Authorization - Biomass:
<https://www.ero-ks.org/zrre/sites/default/files/Publicimet/BRE/09.02.2021%20Registri%20i%20Aplikuesve%20p%C3%A3Abr%20Autorisim%20dhe%20Pranim%20ne%20Skemen%20Mbe....pdf>



Mekanizmat financiarë

përmes mekanizmave financiarë, qytetarët marrin një shumë të caktuar ose mbështetje të plotë financiare. Është mekanizmi më i zakonshëm që shumica e vendeve kanë aplikuar për të siguruar dhe stimuluar përdorimin e pajisjeve të qëndrueshme të ngrohjes dhe masave të eficiencës së energjisë për ekonomitë familjare. Vende të tilla si Franca, Irlanda dhe Republika e Çekisë kanë përdorur mekanizma financiarë. Në Francë, MaPrimeRénov' është një program i ndihmës shtetërore për financimin e projekteve në rinvimin e ndërtesave dhe ngrohjen. Skema është e shkallëzuar në katër kategori bazuar në shumën e të ardhurave (kategoria e parë me të ardhura më të ulëta, kategoria e katërt me të ardhura më të larta) dhe të gjithë kanë të drejtë të aplikojnë. Shuma e subvencionit varet nga kategorja e aplikantit dhe potenciali i kursimit të energjisë. Skema mbulon 23-90% të kostove totale [9]. Irlanda, përmes "Përmirësimit Falas të Energjisë në Shtëpi", ofron mbështetje financiare prej 100% për njerëzit në ndihmë për rinvimin dhe sistemet e reja të ngrohjes [16]. Republika Çeke, përmes "Programit të ri të gjelbër për kursime", ka subvencionuar ekonomitë familjare për ta ulur konsumin e energjisë dhe për t'i ulur emetimet e gazzave serrë. Subvencioni mbulon deri në 50% të shpenzimeve të nevojshme, në varësi të llojit të masave të zbatuara. Gjithashtu, Maqedonia e Veriut ka ofruar mekanizma financiarë për qytetarët e saj për të subvencionuar blerjen e PN-ve. Vlera e projektit ishte 10 milionë euro, ku dhjetë mijë ekonomi familjare kanë përfituar nga 1000 euro si mbështetje për blerjen e NP-ve të tyre [10].



Politikat tatimore

janë instrumente politikash që qeveritë përdorin për ta nxitur përdorimin e një produkti ose shërbimi të caktuar. Franca ka përdorur një politikë të zbritjes së tatimeve përmes programit 'Le crédit d'impôt pour la transition énergétique', CITE. Një zbritje deri në 30% e tatimit mbi të ardhurat iu mundësua qytetarëve të cilët ndryshuan pajisjet e tyre të vjetra në pajisje të reja dhe me eficiencë të lartë të energjisë [11]. Për më tepër, ekzistojnë edhe politika të ndryshme tatimore që mund të përdoren si: taksat e karbonit dhe karburantit për përdorimin e lëndëve djegëse fosile, dhe përjashtimet nga taksat për pajisjet ose shërbimet që ofrojnë reduktim të emetimeve [7].



Rritja e ndërgjegjësimit

përbëhet nga një mekanizëm vendimtar për ndryshimin e sjelljeve të qytetarëve në lidhje me përdorimin e tyre të energjisë dhe qasjen drejt zgjidhjeve të energjisë më të pastër. "Le të jetojmë më ngrohtë", një program i krijuar nga qeveria e Letonisë ka shënuar sukses të madh. Objektivi i programit është të rrisë ndërgjegjësimin për rëndësinë e shtëpive të qëndrueshme dhe investimin në masat e eficiencës së energjisë. Ata e bëjnë këtë duke ofruar informata për pajisjet me eficiencë të lartë të energjisë, instrumente financuese për investime, duke edukuar qytetarët dhe palët e tjera të interesuara për kursimin e energjisë. Programi ka arritur të kursejë rreth 240 GWh dhe 25 mijë tonë CO₂ [12].



Ndalimet dhe kufizimet

Ndalimet dhe kufizimet nxisin përdorimin e zgjidhjeve më të qëndrueshme të ngrohjes. Irlanda e ka përdorur praktikën për të ndaluar dhe kufizuar përdorimin e qymyrit bituminoz për ekonomitë familjare. Kufizimi i shitjes, shpërndarjes dhe përdorimit të qymyrit bituminoz filloi në vitin 1990, në Dublin, nëpërmjet akteve legjislative të Aktit Ajri i Pastër, 1987, më pas u shtri në qytetet e tjera të Irlandës përmes akteve të tjera legjislative të vitit 2015 dhe 2020.

Rekomandime

1.

Shtytësit ekonomikë për masat e eficiencës së energjisë dhe karburantet dhe teknologjitet e qëndrueshme

energjia më e qëndrueshme dhe më e lirë është ajo që nuk prodhohet. Prandaj, eficienca e energjisë, pa dyshim, është karburanti dhe objektivi kryesor që duhet të ndjekim. Kjo bëhet duke ndjekur dy rrugë. E para është duke rinnovuar shtëpitë dhe ndërtesat. Duke pasur izolime më të mira, jo vetëm reduktojmë konsumin e ngrohjes por edhe nevojën për ftohje gjatë verës. Përveç kësaj, rritet komoditeti i qytetarëve dhe ulet nevoja për konsum të energjisë elektrike. Rruga e dytë është duke ofruar subvencione për pajisjet e ngrohjes me eficiencë të lartë të energjisë si soba dhe kaldaja. Për të parat, soba me dru ose pelet me eficiencë të lartë të energjisë, dhe për të dytë, kaldaja të avancuara, të cilat mund të jenë prej druri, peleti ose elektrike. Në veçanti, teknologjitet si PN-të dhe termalet diellore duhet gjithashtu të stimulohen. Biomatasat si peleti dhe copat e drurit, zënë një vend vendimtar si lëndë djegëse të qëndrueshme që duhet të përdoren si lëndë djegëse parësore sic është biomasa. Për këtë, këto burime duhet të stimulohen dhe promovohen derisa të arrijnë një maturim në treg. Opcionet e tjera të tilla si lënda drusore, duhet të inspektohet. Për shkak të prerjeve të paligjshme, drujët e zjarrit kushtojnë shumë më lirë se sa burimet e tjera të biomasës. Përfitimet e këtyre masave do të çojnë në: përdorim më pak dhe më të matur të burimeve primare të energjisë, ulje të kërkuesës për energji, kosto më të ulëta operacionale dhe më e rëndësishmja është reduktimi i emetimeve të gazrave serrë dhe përmirësimi i cilësisë së ajrit dhe shëndetit në përgjithësi.

2.

Rritja e ndërgjegjësimit

sjellja e qytetarëve (përfshirë ekonomitë familjare, shërbimet, bizneset dhe industritë) luan një rol vendimtar drejt dekarbonizimit. Për këtë duhet të kriohen programe të veçanta, ku qytetarët mund të informohen për konsumin e energjisë dhe çfarë masash mund të ndërmarrin. Për shembull, përdorimi i duhur i pajisjeve luan një rol të rëndësishëm. Sipas një studimi zviceran, përdorimi i mirë i sobave mund të kursejë deri në 100 herë nivelet e emetimeve [13]. Për më tepër, qytetarët duhet të dinë se çfarë lloji të investimeve duhet të bëjnë. Çfarë lloji të pajisjeve duhet të blejnë? Jo çdo pajisje është e përshtatshme për të gjithë qytetarët (kjo varet nga aktiviteti ekonomik ose vendndodhja urbane e ndërtesës ose shtëpisë). Apo është më mirë të blejnë pajisje të re për ngrohje apo të rinojnjë? Së fundi, qytetarët, bizneset dhe të gjithë aktorët e përfshirë duhet të janë gjithashtu të vetëdijshëm për mundësitet e financimit. Tashmë ka programe që financohen nga institucione financiare ndërkombëtare si GEFF, ku ekonomitë familjare që investojnë në masat e eficiencës së energjisë dhe teknologjitet e gjelbra mund të përfitojnë një shumë prej 20% grant nga totali i investimeve. Prandaj, programet e ndërgjegjësimit që do të informonin dhe do të ndihmonin qytetarët për të marrë vendimin më të mirë përmes këtyre programeve, do t'i nxisin qytetarët të bëjnë ndryshimet dhe investimet e duhura të nevojshme dhe të kontribuojnë drejt dekarbonizimit.¹² Investments needed and contribute toward decarbonisation.

Dekarbonizimi i sektorit të ngrohjes duhet të ndiqet në bazë të gjendjes aktuale që tashmë dominon. Për këtë duhet të merren parasysh tri konsiderata. Së pari, Kosova është një vend në zhvillim me të ardhura të ulëta. Së dyti, është varësia e lartë nga biomasa dhe energjia elektrike. Dhe së treti, është penetrimi i ulët i NQ-së. Nga ana tjetër, duke pasur parasysh se dekarbonizimi është destinacioni ynë, rekomandimet e mëposhtme që duhet të ndjekim për dekarbonizimin e sektorit të ngrohjes janë:

3.

Standardet dhe etiketimet

Qeveria duhet të vazhdojë me transpozimin e direktivës së BE-së 2009/125/EC për eko-projektimin dhe etiketimin e pajisjeve të ngrohjes bazuar gjithashtu në performancën energjetike. Përveç kësaj, pasi që Kosova ka nënshkruar Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit (MSA), ajo ka obligim që t'i transpozojë këto direktiva. Standardet do të shërbejnë për të vendosur kërkesat minimale, ndërsa etiketimi do të ndryshoj sjelljen e autoriteteve publike dhe qytetarëve drejt përdorimit më efikas dhe më të pastër të teknologjive të ngrohjes.

4.

Bashkimi i sektorëve (ngrohje - energji elektrike)

me dekarbonizimin e sistemeve energjetike, elektrifikimi i sektorit të ngrohjes nëpërmjet PN-ve shihet si zgjidhje e spikatur drejt një sektori të ngrohjes të pastër. Prandaj, qeveria duhet të marrë parasysh këtë paradigmë të re dhe të fillojë përgatitjet për elektrifikimin e sektorit të ngrohjes gjithashtu, duke siguruar infrastrukturën adekuate të rrjetit dhe duke hequr barrierat për konsumatorët.

6.

5.

Zgjerimi i ngrohjes qendrore ekzistuese

Sistemi ekzistues i ngrohjes qendrore mund të zgjerohet veçanërisht në Prishtinë, ku gjysma e potentialit është ende e pashfrytézuar. Kjo do të krijonte përfitime për popullsinë lokale që jeton në Prishtinë, duke përmirësuar gjendjen shëndetësore atje si dhe duke përmirësuar koston e mundësive për shoqërinë. Kjo vlen edhe për Gjakovën, ku kapaciteti i NQ-së mund të zgjerohet. Për më tepër, dy nrohtoret në Mitrovicën e Veriut dhe në Zveçan kërkojnë më shumë investime dhe duhet të lëvizin drejt karburanteve miqësore me mjedisin.

Depërtimi i ngrohjes qendrore me burime të ripërtëritshme të energjisë

në mungesë të infrastrukturës së rrjetit të ngrohjes, planifikimi i tij duhet të bëhet duke vënë në qendër përdorimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë si biomasa dhe nxehësia nga mbeturinat bujqësore në kombinim me PN-të. Shembulli më i mirë që duhet ndjekur është ngroha qendrore në Gjakovë që përdor bashkëprodhimin nga biomasa si lëndë djegëse për prodhimin e ngrohjes dhe energjisë elektrike. Kjo mund të përsëritet edhe në qytete të tjera, veçanërisht ato që janë më të vogla në përmasa dhe kanë një fokus të madh në bujqësi. Ndërsa financimi për to mund të sigurohej nga kredi me interesat tona nga institucionet financiare ndërkombëtare.

Përfundim



Pa dyshim, rruga drejt dekarbonizimit të sektorit të ngrohjes do të jetë sfiduese, veçanërisht, nëse nuk ndërmerren masa, situaata mjedisore dhe shëndetësore vetëm do të përkeqësohet. Përderisa sektori i ngrohjes në Kosovë vazhdon pa rrugë të qartë dhe pa nxitje pér qytetarët që të përdorin zgjidhje më të qëndrueshme të ngrohjes, rruga drejt një sektori të ngrohjes së pastër duket larg.

[Prioritizimi i një agjende të qëndrueshme të energjisë që përfshin të gjithë sektorët, duke përfshirë shfaqjen e paradigmave të reja, të tilla si bashkimi i sektorëve (energji-ngaohje), një kombinim i praktikave më të mira duke filluar nga masat stimuluese pér eficiencë të energjisë dhe teknologjitet me karbon të ulët (FV, PN-të, pajisjet me eficiencë të lartë të energjisë), rikonstruksioni, standardet e eko-dizajnit, taksat dhe ndalimet, do të çojnë patjetër drejt një të ardhmeje me një sektor të pastër të ngrohjes.

Vende të tilla si Suedia [14] kanë treguar se edhe në vendet ku lëndët djegëse fosile janë përdorur si burimi kryesor pér ngrohje, është e mundur të dekarbonizohet sektori i ngrohjes. Dhe kjo realizohet përmes politikave mbështetëse dhe mekanizmave financiarë që promovojnë masat e efikasitetit të energjisë dhe teknologjite e pastra të ngrohjes, promovojnë NQ të qëndrueshme dhe u japid mundësi qytetarëve të bëjnë zgjidhje të qëndrueshme përmes programeve të ndërgjegjësimit.


Nuk duhet te ketë dilemë: ne nuk duhet të ndjekim të njëjtën paradigmë të vjetër, por duhet të bëhem i guximshëm dhe të ndjekim rrugën drejt dekarbonizimit të sektorit të ngrohjes dhe të bëhem një nga pionierët në tranzicionin energetik.



Statistikat kryesore - Infografikë



Energjia elektrike dhe biomasa janë burimet kryesore që përdorin qytetarët për ngrohje.



Biomasa përfaqëson 56% të konsumit total të energjisë për ekonomitë familjare.



Në Kosovë ekzistojnë 4 sisteme të ngrohjes qendrore - NQ.



Vetëm 5% e konsumit të ngrohjes mbulohet nga ngrohja qendrore.



Shkalla e konsumit të biomasës vazhdon të rritet. Përdorimi i biomasës është rritur me 60% krahasuar me 2012 dhe 2020.



Mbi 40% e ekonomive familjare nuk mund ta mbajnë shtëpinë e tyre të ngrohtë në mënyrë adekuate - Vlerat në 2018



22% e ekonomive familjare në Kosovë kanë probleme (me çati, mure, dysheme që rrjedhin, themele të lagura, korniza të dritareve dhe dysheme të kalbura) me shtëpitë e tyre. Ndërsa, kjo shifër shkon në 25% për zonat rurale



"Strategjia e Ngrohjes e Republikës së Kosovës 2011 - 2018" është dokumenti më i fundit kushtuar sektorit të ngrohjes së Kosovës.

Referencat



- [1] National Energy Efficiency Action Plan 2019-2021, pg. 7
- [2] Energy Community, 2021, Kosovo Annual Implementation Report
- [3] World Bank, 2017, Biomass-Based Heating in the Western Balkans - A Roadmap for Sustainable Development
- [4] Energy Community, 2020, Kosovo Annual Implementation Report
- [5] Energy Efficiency Council, 2021, Accessed on: November, 2021: <https://www.eec.org.au/for-energy-users/technologies-2/heat-pumps>
- [6] Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2018, Përballueshmëria e ekonomive familjare për të mbajtur shtëpinë të ngrohtë në mënyrë adekuate, Accessed on: November 2021: <https://askdata.rks-gov.net/PXWeb/pxweb/sq/ask-data/ask-Anketa%20mbi%20t%C3%ab%20Ardhurat%20dhe%20Kushtet%20e%20Jetes%3abs/silc10.px/?rxid=ade3a4da-b974-453d-88e2-be13bfa34a5>
- [7] Inter-American Development Bank, 2012, The Role o f Green Fiscal Mechanisms in Developing Countries: Lessons Learned, Accessed on: October, 2021: <https://publications.iadb.org/publications/english/document/The-Role-of-Green-Fiscal-Mechanisms-in-Developing-Countries-Lessons-Learned-Case-Study.pdf>
- [8] Odyssee-Mure, Successful Energy Efficiency Measures, Accessed on: November, 2021: <https://www.measures.odyssee-mure.eu/successful-efficiency-measures-tool.html#/results>
- [9] MaPrimeRénov', 2021, Les nouveautés de MaPrimeRénov', Accessed on: October, 2021: https://www.ecologie.gouv.fr/sites/default/-files/19164_maPrimeRenov_DP_Janvier%202021.pdf
- [10] Balkan Green Energy News, North Macedonia's ESM to subsidize purchase of inverter air conditioners with EUR 10 million, Accessed on: November, 2021: <https://balkangreenenergynews.com/north-macedonia-esm-to-subsidize-purchase-of-inverter-air-conditioners-with-eur-10-million/>
- [11] Bridging European and Local Climate Action, 2018, The Energy Transition TAX Credit (CITE) in France, Accessed on: September, 2021: https://www.euki.de/wp-content/uploads/2019/09/20180827_FR_CITE_Study.pdf
- [12] Ministry of Economics, Republic of Latvia, "Let's Live Warmer", Accessed on: October, 2021: <https://www.em.gov.lv/en/lets-live-warmer>
- [13] Clean Heat EU, Residential wood burning Environmental Impact and Sustainable Solutions, Accessed on: November, 2021: <https://www.clean-heat.eu/en/actions/info-material/download/background-paper-residential-wood-burning-3.html>
- [14] Swedish Energy Agency, Energiindikatorer 2013-Uppföljning av Sveriges energipolitiska mål, Energimyndigheten ER, 2013
- [15] Energy Regulatory Office, Register of Applications for construction of new generating capacities and Admission to Support Scheme from RES. <https://www.ero-ks.org/zrre/sites/default/files/Publicimet/BRE/09.02.2021%20Regjistri%20i%20Aplikuesve%20p%C3%ABr%20Autorizim%20dhe%20Pranim%20ne%20Skemen%20Mbe....pdf>
- [16] Sustainable Energy Authority of Ireland, Free Energy Upgrades, Accessed on November 2021: <https://www.seai.ie/grants/home-energy-grants/free-upgrades-for-eligible-homes/>